



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:211846

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05450712

P.nr.832/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit A.I nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-ës, të cilin me autorizim e mbron avokati Sherif Sherifi nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1488/2023, të datës 15.11.2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 28.02.2024 në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu dhe i pandehuri i lartcekur së bashku me mbrojtësin e tij mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 14.03.2024, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A.I, nga babai N, dhe nëna N e lindur K, i lindur me datë ...në Gjilan, ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 05 shtator 2023, rreth orës 01:00 h, në Gjilan, përkatësisht në rrugën....., patrulla e Stacionit Policor në Gjilannë përbërje të zyrtarëve policor V.D, Sh.Z dhe A.H, kur e kishin pyetur të pandehurin A.I me fjalët "pse ikët me veturë në rrugën e Kumanovës", i pandehuri e kishte kanosur me fjalë zyrtarin policor V.D duke i thënë "ti jeton në Gilan të njoh unë ty, ki me

pas problem” të cilat i kishte përsëritur disa herë me tone të larta kërcënuese, dhe i njëjti duke mos përfillur urdhrat e zyrtarit policor kishte tentuar që të largohet nga aty, duke rezistuar fizikisht dhe duke e kapur për duksi të uniformës policore, dhe në momentin e fillimit të arrestimit, i pandehuri e godet të dëmtuarin – zyrtarin policor V.D me kokë me pjesën e ballit duke i shkaktuar lëndime në kokë, e gjithashtu më pas edhe në momentin e kontrollimit të veturës së tij, i njëjti përsëri e godet me bërrylin e dorës së majtë në pjesën e brinjëve të anës së majtë duke i shkaktuar lëndime trupore dhe tenton të largohet por i njëjti nuk arrin të ikë pasi që arrin të ndalet nga policia, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime trupore, ku i njëjti edhe ka marr tretman mjekësor në Emergjencën e Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan.

- Me çka ka kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 230 e 364 të KPP-ës të pandehurin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-ës, i ZËVËNDËSOHET në dënim me gjobë në shumën prej 800 € (tetëqind euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari V.D, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes dhe vlerësimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë

Prokuroria Themelore në Gjiilan- Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.11.2023 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1488/2023 kundër të pandehurit A.I, nga Gjiilani, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-ës, ndërsa me datë 14.02.2024 pranë kësaj gjykate kjo prokurori ka dorëzuar edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.nr.1488/2023, të arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit të lartcekur me mbrojtësin e tij në anën tjetër.

Me datë 28.02.2024 pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, mbrojtësi i të pandehurit avokati Sherif Sherifi dhe i pandehuri A.I ndërsa ka munguar i dëmtuari V.D, i cili për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së seancës kishte qenë i njoftuar nga procesverbali i seancës së mëparshme, në këtë seancë është shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë me ç'rast pas dëgjimit të palëve gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen e lartcekur ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 230 paragrafi 17 dhe 18 të KPP-ës, në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij në anën tjetër i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 230 të KPP-ës, po ashtu me rastin e pranimit të kësaj marrëveshje gjykata ka konstatuar edhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale të cilat i përmban aktakuza siç janë: kallëzimi penal me numër të rastit 2023-CA-1282 i datës 26.09.2023, fletëparaqitja për kundërvajtje ndaj O.K e datës 19.09.2023, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotografitë nga Njësia e Forenzikës e datës 06.09.2023, raporti fillestar i incidentit i datës 05.09.2023, deklarata e të pandehurit A.I e dhënë në polici e datës 05.10.2023, deklarata e të pandehurit A.I e dhënë në prokurori e datës 06.10.2023, deklarata e dëshmitarit O.K e dhënë në polici e datës 19.09.2023, verifikimi lidhur me të kaluarën kriminale të personit, fotografi, raporti mbi automjetin e tërhequr me numër 175/23 i datës 05.09.2023, raporti i oficerit Sh.Z i datës 05.09.2023, deklarata e dëshmitarit Sh.Z e dhënë në prokurori e datës 16.10.2023, raporti i oficeres A.H i datës 05.09.2023, deklarata e dëshmitares A.H e dhënë në Prokurori e datës 16.10.2023, raporti i oficerit A.J i datës 05.09.2023, raporti i oficerit

V.D i datës 05.09.2023, raporti mjekësor i lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Regjional në Gjilan në emër të V.D me numër të protokollit 21999 e datës 05.09.2023, raporti mjekësor i lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Regjional në Gjilan në emër të V.D me numër të protokollit 21999 e datës 05.09.2023, raporti mjekësor i lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Regjional në emër A.I me numër të protokollit 22001 e datës 05.09.2023, ekspertiza mjeko ligjore me numër të referencës 0061473 e datës 31.10.2023 në emër të V.D, ekspertiza mjeko ligjore me numër të referencës 0061473 e datës 31.10.2023 në emër të A.I, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 05.09.2023, dhe shkresa të tjera e tjera të lëndës, po ashtu gjykata në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 249 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

2.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri A.I e ka kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

3. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ndërsa si rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë përkatësisht ka pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as vepra të tjera penale, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori edhe rrethanat personale të tij për faktin se për të njëjtin kjo ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin meqenëse më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, ndërsa rrethanë rënduese si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës, gjykata mori faktin se i pandehuri me

veprimet e tija e kishte kanosur zyrtarin policor dhe duke mos përfillur urdhrat e zyrtarit policor kishte tentuar që të largohet nga aty dhe në momentin e arrestimit i pandehuri e kishte goditur zyrtarin policor-të dëmtuarin V.D me ç'rast të dëmtuarit i kishte shkaktuar lëndime trupore ku edhe kishte marr tretman mjekësor në Emergjencën e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës, gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Gjykata duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës të dëmtuarin V.D, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

5.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej nga 20 € (njëzetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.832/2023 me datë 14.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Shqipe Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.